



TË DREJTAT DHE DETYRIMET TUAJA GJATË PRITJES



Ky informacion është për ju në rast se:

- ✓ jeni nën 18 vjeç
- ✓ keni mbërritur pa prindërit tuaj, qoftë vetëm apo me pjesëtarë të tjerë të familjes
- ✓ keni paraqitur kërkesë për azil (ose siç njihet ndryshe mbrojtje ndërkombëtare) në Irlandë.

Ju jeni të sigurt në këtë vend	3
Kush do t'ju ndihmojë?	3
Cili është roli i përfaqësuesit ?	3
Kush tjetër mund t'ju ndihmojë?	4
Çfarë do të përfitoni?	6
E drejta për kujdes shëndetësor	8
Informoni stafin dhe përfaqësuesin	9
Çfarë është vlerësimi i interesit më të lartë?	10
E drejta për arsimim	10
E drejta për të punuar	11
Dokumenti juaj i azilkërkuesit	11
Ku do të qëndroni?	12
Si mund të veproni në rast se dikush ju trajton keq?	13
Cilat janë detyrimet tuaja gjatë pritjes?	14
Çfarë ndodh nëse nuk i përmbushni detyrimet tuaja?	15
Rregullat për paraqitjen e kërkesës për azil dhe për udhëtimin drejt vendeve të tjera	16
Çfarë ndodh nëse largoheni drejt një prej vendeve të BE+?	17
Kush mund t'ju ndihmojë nëse nuk bini dakord me një vendim të marrë nga autoritetet?	18
Çfarë ndodh nëse ndryshon ndonjë aspekt i mbështetjes?	19
Të dhënat e kontaktit	20

➤ JU JENI TË SIGURT NË KËTË VEND

Ju jeni shprehur përpara autoriteteve se nuk mund të ktheheni në vendin tuaj, për shkak se ndodheni në rrezik dhe keni bërë kërkesë për azil. Ju jeni azilkërkues në Irlandë.

Është normale nëse çdo gjë ju duket e re. Ju jeni të sigurt në këtë vend dhe nuk do të jeni vetëm.

➤ KUSH DO T'JU NDIHMOJË?

Në Evropë, të gjithë personat nën 18 vjeç konsiderohen si fëmijë dhe kanë të drejtën të përfitojnë **mbështetje të posaçme**.



Për shkak se ju ndodheni këtu pa prindërit tuaj, një i rritur tjetër i cili njihet si **përfaqësues** do t'ju ndihmojë me nevojat tuaja. Ky person është i pavarur nga autoritetet.

Nëse nuk e keni takuar ende përfaqësuesin tuaj, do ta takoni atë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Deri atëherë, autoritetet do të caktojnë një të rritur tjetër për t'ju mbështetur dhe përfaqësuar.

➤ CILI ËSHTË ROLI I PËRFAQËSUESIT?

Përfaqësuesi juaj ju shpjegon gjithçka që duhet të dini në lidhje me qëndrimin tuaj dhe ju ndihmon të merrni përgjigje për pyetjet tuaja. Për shembull, për mënyrën se si mund të shkoni në shkollë, si mund të takoni një mjek, ku do të jetoni, si mund të gjeni ose të kontaktoni familjen tuaj. Anëtarë të tjerë të stafit do t'ju ndihmojnë gjithashtu me këto pyetje.

Përfaqësuesi juaj informon autoritetet lidhur me nevojat tuaja, si dhe ju këshillon dhe ju ndihmon në marrjen e vendimeve të rëndësishme.

Ju mund t'i shprehni gjithmonë nevojat dhe ndjenjat tuaja dhe t'i tregoni Përfaqësuesit opinionin tuaj.

Nëse keni ndonjë problem me përfaqësuesin tuaj, informoni stafin.

➤ KUSH TJETËR MUND T'JU NDIHMOJË?



- Një **punonjës social** do t'ju ndihmojë për nevojat e përditshme ose do të kontaktojë persona të tjerë të rritur të cilët mund të ndihmojnë për një problem konkret.
- Një **mjek** ose një **infermiere** do t'ju ndihmojë në qoftë se do të sëmurëni, do të vriteni apo do të keni nevojë për çdo lloj ndihme mjekësore.
- Një **psikolog** do t'ju ndihmojë në qoftë se do të ndieni trishtim, zemërim, frikë apo nëse do të keni probleme me gjumin.
- Një **këshilltar ligjor** do t'ju ndihmojë të kuptoni se çfarë do të ndodhë gjatë procedurës së azilit dhe në rast se mendoni se të drejtat tuaja nuk janë respektuar.
- Një **përkthyes** mund t'ju ndihmojë të komunikoni në një gjuhë që e kuptoni. Përkthyesi ka për detyrë të përkthejë saktësisht ato që thoni ju dhe të tjerët.

Çfarë është vlerësimi i moshës?



Nëse keni mbërritur në Evropë pa asnjë dokument që vërteton se sa vjeç jeni dhe nëse autoritetet kanë dyshime në lidhje me moshën tuaj, ata do t'ju kërkojnë të merrni pjesë në një procedurë të quajtur **vlerësimi i moshës**. Në këtë mënyrë, ata mund të vendosin nëse ju konsiderojnë fëmijë apo jo. Nëse ju kërkohet të merrni pjesë në një procedurë të vlerësimit të moshës, përfaqësuesi juaj do t'ju shpjegojë procedurën.

Çfarë mund të bëni nëse dëshironi të kontaktoni me familjen tuaj?

- Nëse nuk e dini se ku ndodhet familja juaj, ose nëse keni humbur kontaktin me ta, mund të kërkonti ndihmën e përfaqësuesit tuaj ose të stafit. Ata do t'ju ndihmojnë të kërkonti familjen tuaj.
- Nëse e dini se ku është familja juaj dhe keni të dhënat e kontaktit të tyre, stafi mund t'ju ndihmojë t'i telefononi nëse dëshironi.
- Nëse keni familje në Evropë, informoni stafin rreth gjithçkaje që dini për familjen tuaj.



Kini kujdes, disa njerëz mund t'ju vënë në rrezik



Ju mund të mendoni të largoheni nga ky vend ose njerëz të caktuar mund të përpiqen t'ju bindin që të largoheni. Ai mund t'ju vërë në rrezik dhe mund të ketë pasojë negative për kërkesën tuaj për azil. Bisedoni me përfaqësuesin dhe me stafin. Mund t'u shpjegoni situatën dhe ata mund t'ju këshillojnë.

➤ ÇFARË DO TË PËRFITONI?

Ju do të përfitoni lloje të ndryshme mbështetjeje ndërkohë që prisni që autoritetet të shqyrtojnë kërkesën tuaj për azil. Kjo quhet **pritje**.


Si fëmijë dhe si azilkërkues, ju keni të drejta, por edhe detyrime që duhet t'i respektoni. Ato shpjegohen në këtë broshurë.

Stafi do t'ju kërkojë të konfirmoni se e keni marrë informacionin në këtë broshurë. Nëse nuk kuptoni ndonjë pjesë të kësaj broshure apo nëse keni pyetje, pyesni përfaqësuesin dhe stafin.

Gjatë qëndrimit tuaj në këtë vend, përfaqësuesi dhe stafi do t'ju japin informacione të mëtjshme në varësi të situatës suaj specifike. Ju mund të bëni pyetje në çdo kohë.



Ju do të përfitoni:



- një vend për të fjetur



- ushqim



- produkte të higjienës personale



- veshmbathje



- para për shpenzime ditore

DREJTA PËR KUJDES SHËNDETËSOR

Autoritetet do të sigurohen që të merrni kujdesin shëndetësor që ju nevojitet. Ju mund të informoni stafin dhe përfaqësuesin tuaj për çdo problem shëndetësor që keni.

Kjo mund të përfshijë:

- takime me një infermier/e ose mjek
- trajtim për një dëmtim ose sëmundje
- kujdes nëse keni dhimbje ose nuk ndiheni mirë
- akses në ilaçet që ju nevojiten
- mbështetje për shqetësime urgjente të shëndetit mendor
- referim te shërbime të tjera shëndetësore nëse është e nevojshme.



Shërbimi Ekzekutiv i Shëndetësisë (HSE) mund t'ju bëjë disa pyetje rreth shëndetit tuaj. Ata mund t'ju pyesin për:

- çdo dëmtim, dhimbje ose problem urgjent shëndetësor
- çdo gjendje mjekësore që keni
- çdo ilaç që po merrni aktualisht
- historikun tuaj të vaksinimeve
- çdo sëmundje të kohëve të fundit ose sëmundje të rëndë.

Ky informacion e ndihmon HSE-në të identifikojë çdo nevojë urgjente shëndetësore dhe të organizojë trajtimin sa më shpejt të jetë e mundur.

Nëse keni nevojë për ndihmë urgjente mjekësore

Nëse keni një urgjencë mjekësore ose ndonjë dëmtim që kërkon trajtim urgjent, njoftoni stafin. Nëse jeni jashtë vendit ku po qëndroni, mund të telefononi **falas në numrin e urgjencës 112 ose 999** dhe të kërkonin një ambulancë.

Marrja e kujdesit dhe mbështetjes shëndetësore


Përfaqësuesi juaj do t'ju ndihmojë të regjistrohesh te një **GP (mjek)**.

▶ INFORMONI STAFIN DHE PËRFAQËSUESIN NËSE:



- nuk ndiheni mirë, keni pësuar ndonjë lëndim apo ju nevojitet ndihmë mjekësore apo mjekim urgjent
- përdorni droga ose konsumoni alkool
- jeni përballur me dhunë ose abuzim në të kaluarën ose po përballeni tani
- jeni ose mund të jeni shtatzënë
- nuk ecni dot vetë ose keni vështirësi me dëgjimin dhe shikimin
- jeni shumë të shqetësuar, të mërzitur, nuk flini dot apo keni mendime negative
- ndiheni të pasigurt apo keni frikë nga dikush, qoftë i panjohur apo një person që e njihni
- ju kanë detyruar apo po ju detyrojnë të bëni gjëra kundër dëshirës suaj
- ndiheni të pasigurt për shkak të besimit tuaj, personit që doni, mënyrës sesi visheni apo silleni.

Mos harroni, stafi dhe përfaqësuesi juaj janë këtu për t'ju ndihmuar.



➤ ÇFARË ËSHTË VLERËSIMI I INTERESIT MË TË LARTË?



Ky është një aktivitet ku do të shihni edhe pjesëtarë të tjerë të stafit të cilët do t'ju bëjnë pyetje me qëllim që:

- të kuptojnë **nevojat tuaja**
- të vendosin për llojin e **mbështetjes** që ju nevojitet.

Kjo do t'i ndihmojë autoritetet të marrin vendime të rëndësishme, si për shembull ku do të qëndroni.

Ju mund të keni besim tek infermieri, mjeku, stafi dhe te përfaqësuesi juaj. Mund të ndani gjithçka me ta. Asgjë nga ato që thoni nuk do të ndahet me askënd tjetër përveç përfaqësuesit tuaj pa pëlqimin tuaj. Përrjashtim bëjnë vetëm rastet kur jeta juaj apo e dikujt tjetër është në rrezik.

Nëse nuk dëshironi që përfaqësuesi juaj të informohen apo të përfshihen, njoftoni stafin. Ata do ta shqyrtojnë kërkesën tuaj dhe do të marrin një vendim duke u bazuar në interesin tuaj më të lartë.

➤ E DREJTA PËR ARSIM



Si fëmijë, ju keni të drejtën të arsimoheni dhe të mësoni. Nëse shkoni në shkollë dhe mbushni 18 vjeç gjatë kësaj kohe, mund të vazhdoni frekuentimin derisa shkolla të përfundojë.

Përfaqësuesi juaj dhe stafi do t'ju ndihmojnë të regjistroheni në shkollën lokale. Ata do t'ju informojnë në lidhje me kurset përgatitore të gjuhës dhe kurse të tjera. Ju mund t'ju duhet të frekuentoni disa nga këto kurse.

Stafi do t'ju informojë në lidhje me aktivitetet edukative dhe rekreative që do t'ju ndihmojnë të mësoni, të zhvilloheni dhe të bëni miq të rinj.

▶ E DREJTA PËR TË PUNUAR

Në varësi të moshës dhe rrethanave tua, mund t'ju lejohet të punoni në Irlandë, nëse dëshironi. Përfaqësuesi juaj dhe stafi do t'ju japin më shumë informacion.



Djemve dhe vajzave nën 14 vjeç nuk u lejohet të punojnë.

▶ DOKUMENTI JUAJ I AZILKËRKUESIT

Ju do të merrni një dokument personal me emrin dhe fotografinë tuaj. Kjo tregon se ju jeni azilkërkues në Irlandë. Këtë dokument duhet ta mbani gjithmonë me vete.



Ky dokument është i rëndësishëm. Bëni kujdes të mos e humbni dokumentin dhe mos ia jepni atë askujt tjetër.

Ky dokument quhet International Protection Application Card

KU DO TË QËNDRONI?

Vendi ku do të qëndroni ndërkohë që autoritetet shqyrtojnë kërkesën tuaj për azil varet nga mosha dhe nevojat tuaja.



Përfaqësuesi juaj dhe stafi do t'ju informojnë **se ku duhet të qëndroni**, për shembull në një akomodim të caktuar ose në një qytet.

Ju do të përfitoni mbështetje dhe shërbime vetëm në vendin e vendosur nga autoritetet.

Shumë rrallë, fëmijët mund të vendosen në një qendër ku nuk mund të hyjnë e të dalin sipas dëshirës. Nëse ndodheni në këtë situatë, do të asistoheni nga përfaqësuesi juaj, nga një këshilltar ligjor dhe nga stafi.

Pavarësisht vendit ku po qëndroni, ju keni të drejtën të jeni të sigurt. Askujt nuk i lejohet:



t'ju kërcënojë



t'ju fyejë



t'ju lëndojë

Nuk ka rëndësi nëse bëhet fjalë për një të panjohur apo për një person që e njihni.


Nëse keni probleme me stafin ose me përfaqësuesin tuaj, mos hezitoni ta flisni këtë.

▶ SI MUND TË VEPRONI NË RAST SE DIKUSH JU TRAJTON KEQ?



Ju mund të flisni me një person të besuar, me një anëtar tjetër të stafit, me përfaqësuesin tuaj, ose stafi në qendrën tuaj të akomodimit.

Nëse dikush ju trajton keq, ju mund ta raportoni pranë autoriteteve për t'u siguruar që kjo të mos përsëritet më. Një gjë e tillë quhet “depozitim ankese”.



Vëmendje!

Nëse ndodheni jashtë vendit ku po qëndroni dhe jeni në rrezik, mund të telefononi pa pagesë në numrin kombëtar të emergjencave 112 nga çdo telefon.

CILAT JANË DETYRIMET TUAJA GJATË PRITJES?



Është e rëndësishme që të tregoni të vërtetën dhe të bashkëpunoni me autoritetet, edhe nëse ndonjëherë ju duket e frikshme dhe e vështirë që të rrëfeni historinë tuaj. Nuk jeni vetëm. Përfaqësuesi juaj dhe stafi janë këtu për t'ju dëgjuar dhe për t'ju ndihmuar me nevojat tuaja të përditshme.

Stafi mund t'ju vijë në ndihmë nëse ka dijeni për situatën tuaj.

Kudo që të qëndroni, ka rregulla që duhen ndjekur. Për shembull, ju duhet të respektoni rezidentët e tjerë dhe stafin dhe nuk duhet të bëni zhurmë gjatë orareve të qetësisë.

Stafi do të shpjegojë rregullat dhe pasojat kur rregullat nuk respektohen.

Është shumë e rëndësishme që ju:

-  të ndiqni rregullat e vendit ku po qëndroni
-  të mos largoheni nga vendi ku autoritetet ju kanë thënë të qëndroni
-  të respektoni ligjet e këtij vendi, të cilat do t'ju shpjegohen nga stafi dhe nga përfaqësuesi juaj.

➤ ÇFARË NDODH NËSE NUK I PËRMBUSHNI DETYRIMET TUAJA?



Nëse kjo ndodh, ju mund të flisni hapur me përfaqësuesin tuaj ose me stafin dhe t'u shpjegoni situatën dhe arsyet që keni patur.

Autoritetet do të vlerësojnë situatën tuaj dhe do t'ju informojnë juve dhe përfaqësuesin tuaj nëse vendosin të marrin masa.

Autoritetet mund të vendosin që:

- **Ju mund të përfitoni më pak mbështetje**, për shembull, nëse largoheni nga vendi ku autoritetet ju kanë thënë të qëndroni ose nëse nuk bashkëpunoni me autoritetet.
- **Ju mund ta humbni mbështetjen që po përfitoni** nëse tregoheni të dhunshëm ose nëse thyeni rregullat e vendit ku po qëndroni në mënyrë të përsëritur apo të rëndë. Mund të thërritet edhe policia.



Tani ju ndodheni në Irlandë, i cili është një vend i BE+.

Vendet e BE+ janë:



27 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE): Austria, Belgjika, Bullgaria, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Greqia, Gjermania, Holanda, Hungaria, Italia, Kroacia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Polonia, Portugalia, Qipro, Republika e Irlandës, Republika Çeke, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia dhe



4 vende të tjera: Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra.



RREGULLAT PËR BËRJEN E KËRKESËS PËR AZIL DHE PËR UDHËTIMIN DREJT VENDEVE TË BE+



Përfaqësuesi juaj dhe stafi IPO do t'ju shpjegojnë këto rregulla të rëndësishme. Ju mund të bëni pyetje në çdo kohë.



Ju duhet të qëndroni në Irlandë dhe të mos largoheni drejt ndonjë prej vendeve të tjera të BE+.



Nëse keni familjarë në ndonjë prej këtyre vendeve, autoritetet do t'ju informojnë në lidhje me të drejtat tuaja për bashkim familjar. Ju nuk mund thjesht të largoheni.



Nëse largoheni, do të përballeni me pasoja negative, të cilat shpjegohen në këtë broshurë. Për shembull, do të përfitoni më pak mbështetje gjatë pritjes në vendin tjetër.




Mos harroni se duhet ta regjistroni kërkesën tuaj për azil në vendin e BE+ ku keni mbërritur fillimisht, me përjashtim të rastit kur autoritetet ju kanë informuar ndryshe.



Vetëm një nga këto vende është përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesës suaj për azil. Autoritetet në Irlandë do t'ju informojnë cili është vendi përgjegjës për këtë.

Ju do të informoheni në lidhje me këto procedura në broshura të posaçme.

➤ ÇFARË NDODH NËSE LARGOHENI DREJT NJË PREJ VENDEVE BE+?



Në Irlandë :

- procedura juaj e azilit mund të ndërpritet.

Në vendin tjetër të BE+:

- autoritetet mund të vendosin t'ju kthejnë në vendin e BE+ prej të cilit jeni larguar.

Nga momenti kur autoritetet ju njoftojnë në lidhje me vendimin e kthimit, ju nuk do të keni më akses në disa të drejta, si për shembull:

- nuk do të përfitoni disa lloje mbështetjeje dhe
- nuk do t'ju lejohet të punoni.

➤ KUSH MUND T'JU NDIHMOJË NËSE NUK BINI DAKORD ME NJË VENDIM TË MARRË NGA AUTORITETET?

Ju mund të flisni me përfaqësuesin tuaj dhe t'i bëni çfarëdolloj pyetjeje.

Së bashku me përfaqësuesin tuaj mund të kërkon ndihmë nga një këshilltar ligjor.

Këshilltari ligjor është një person që i njeh rregullat e këtij vendi dhe mund të analizojë situatën tuaj dhe t'ju vijë në ndihmë.



Stafi do t'ju informojë edhe në lidhje me organizatat joqeveritare që mund t'ju japin gjithashtu informacione dhe ndihmë.



Ju mund të kontaktoni në çdo kohë Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR). UNHCR mbron personat që janë detyruar të largohen nga vendi i tyre.

➤ ÇFARË NDODH NËSE NDRYSHON NDONJË ASPEKT I MBËSHTETJES?

Nëse autoritetet vendosin të kufizojnë ose anulojnë disa lloje mbështetjeje për shkak të situatës siç shpjegohet në faqen 15, ju do të jeni ende në gjendje:



- të frekuentoni shkollën



- të takoni një mjek ose një infermiere dhe të merrni ndihmë mjekësore



- të përfitoni ndihmë bazuar në situatën dhe nevojat tuaja personale, që do të thotë një vend për të fjetur në një vendndodhje të përcaktuar nga autoritetet dhe të përfitoni mbështetje.

Kur autoritetet vendosin të anulojnë mbështetjen që ofrohet për ju gjatë pritjes për shkak se ju jeni larguar dhe keni shkuar drejt një vendi tjetër të BE+, lloji i mbështetjes që ju do të vazhdoni të përfitoni do të varet nga rrethanat dhe nevojat tuaja. Ju do të vazhdoni të keni të drejtën për të frekuentuar shkollën.

TË DHËNAT E KONTAKTIT

Nëse keni pyetje apo keni nevojë për mbështetje gjatë qëndrimit tuaj, mund

autoritetit të pritjes



An Roinn Dlí agus Cirt,
Gnóthaí Baile agus Imirce
Department of Justice,
Home Affairs and Migration

International Protection Accommodation Service
Shërbimi Ndërkombëtar i Akomodimit të
Mbrojtjes

Departamenti i Drejtësisë, Çështjeve të
Brendshme dhe Migracionit

51 St Stephen's Green, Dublin 2, D02 HK52

Email: IPASinbox@justice.ie

një autoriteti tjetër përkatës



An Oifig um Chosaint
Idirnáisiúnta
International Protection
Office

The International Protection Office

Zyra Ndërkombëtare e Mbrojtjes

Departamenti i Drejtësisë, Çështjeve të
Brendshme dhe Migracionit

Faqja e internetit: <https://ipo.irishimmigration.ie>

një autoriteti tjetër përkatës



tara

Tinne Tearmaín agus
Acheimhalra um Fhileagáil
Tribunal for Asylum and
Return Appeals

Tribunal for Asylum and Returns Appeals

Gjykata për Apele për Azilin dhe Kthimet

6/7 Hanover Street East

Dublin 2, D02 W320

Faqja e internetit: www.asylumappeals.ie

Ju mund të kontaktoni gjithashtu me këto organizata për pyetje në lidhje me:

mbështetjen mjekësore



Në rast urgjence mjekësore, telefononi 999 ose 112 dhe kërkonit një ambulancë.

Për mbështetjen e përgjithshme të kujdesit shëndetësor në zonën tuaj, flisni me stafin në Qendrën tuaj të Akomodimit.

Ju gjithashtu mund të telefononi HSELive falas në 1800 700 700. Ata mund të japin detajet e kontaktit për Ekipin Shëndetësor të Migrantëve HSE në zonën tuaj.

mbështetjen psikosociale



Kryqi i Kuq Irlandez ofron mbështetje për shëndetin mendor dhe mirëqenien për njerëzit që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare. Vizitoni faqen e tyre të internetit këtu për më shumë informacion.

Shërbimi HSE Cork dhe Kerry (shih këtu për informacion) ofron video online në arabisht dhe persisht rreth:

Traumës dhe PTSD

Menaxhimit të problemeve të gjumit

Ankthi

Shqetësimeve të tjera të shëndetit mendor.

Këshilli Irlandez i Refugjatëve ofron informacion rreth organizatave që mbështesin njerëzit që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në Irlandë (shih hartën).

mbrojtjen e fëmijëve



Ombudsman for Children

Millennium House, First Floor

52-56 Great Strand Street, Dublin 1, D01 F5P8

Website: <https://www.oco.ie/>

linjën telefonike për fëmijët në rrezik



Nëse ndiheni të neglizhuar apo në rrezik, mund të telefononi pa pagesë në numrin 119

Nëse vëllai, motra apo një mik ose mikeshë e juaja ka humbur, mund të telefononi Linjën telefonike 116 000 - Missing Children Europe

këshillimin, asistencën dhe përfaqësimin ligjor



Këshillimi ligjor do t'ju vihet në dispozicion në Qendrën e Konventave Citywest në Shërbimin e Këshillimit të Bordit të Ndhmës Juridike Citywest.

Ju mund të aplikoni për këshilla ligjore dhe përfaqësim (ndihmë juridike) nga Bordi i Ndhmës Juridike në Qendrën e Konventave Citywest ose në një nga këto 3 Qendra Juridike:

1. **Dublin:** Smithfield Law Centre
 (01) 646 9600
2. **Cork:** Popes Quay Law Centre
 087 945 1132
3. **Galway:** Galway Law & Family Mediation Centre
 091 568 467 / 01 646 9637

Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) që mbron interesat dhe të drejtat e azilkërkuesve dhe refugjatëve



UNHCR, Merrion House, Suite 4, 1-3 Lower Fitzwilliam Street, Dublin 2, Ireland

Website: <https://help.unhcr.org/>.

Email: iredu@unhcr.org

Phone (Protection Unit): +353 1 631 4613

Mbështetje për Integrimin	https://www.localgov.ie/lait-contact-details
Mbështetje për t'u kthyer në vendin tuaj të origjinës	voluntaryreturns@justice.ie

Nëse keni një emergjencë mjekësore dhe jeni në rrezik, kontaktoni stafin. Ata do t'ju ndihmojnë.

Në rast se ndodheni jashtë vendit ku po qëndroni dhe pësoni një aksident apo jeni në rrezik, mund të telefononi këta numra emergjence pa pagesë:



urgjenca mjekësore: 112/999



policia: 112/999

Nëse nuk keni telefon, mund t'i kërkonit dikujt ta telefonojë numrin e emergjencës për ju.



An Roinn Dlí agus Cirt,
Gnóthaí Baile agus Imirce
Department of Justice,
Home Affairs and Migration

Kjo broshurë është vetëm për qëllime informuese. Ajo nuk krijon në vetvete të drejta apo detyrime. Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA) ka siguruar strukturën kryesore të këtij materiali dhe riprodhimi dhe ndryshimi i kësaj broshure autorizohet nga EUAA vetëm për shtetet anëtare të BE-së. EUAA nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi apo detyrim për saktësinë, përmbajtjen, plotësinë, ligjshmërinë ose besueshmërinë e informacionit të përfshirë në këtë faqe nga shtetet anëtare të BE-së ose nga ndonjë palë tjetër e tretë përgjegjëse. EUAA dhe çdokush që vepron në emër të EUAA-së nuk mbajnë përgjegjësi për përdorimin që mund t'u bëhet informacioneve që përmban kjo broshurë.